



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë ABC News SHA nga Z. Aleksandër Frangaj dhe Znj. Alba Ginaj.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa me Nr. 348 Prot., protokoll i AK, datë 30.05.2019 “Njoftim kontrate për shitblerjen e aksioneve datë 21.05.2019”, me anë të së cilës informohemi në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë ABC News SHA nga Z. Aleksandër Frangaj dhe Znj. Alba Ginaj.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

**Pala shitëse:** Z. Redi Sata, individ, i cili zotëron 60% të kapitalit të shoqërisë ABC News SHA përkatësisht 129.000,00(njëqind e njëzet e nëntë mijë) aksione me vlerë nominale 1000(njëmijë) lekë.

**Pala blerëse:**

**Z.Aleksandër Frangaj, (Bleresi 1)**, individ, i cili zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë ABC News SHA përkatësisht 43.000,00(dyzet e tre mijë) aksione.

**2.Alba Gina, (Blerësi 2)**, individ, e cila zotëron zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë ABC News SHA përkatësisht 43.000,00(dyzet e tre mijë) aksione.

**Shoqëria Target:** ABC News SHA, është një shoqëri anonime, e regjistruar më datë 10.05.2000, themeluar më datë 19.04.2000, e cila zhvillon aktivitetin e saj sipas licencës nr.037/TVL “Për Televizionin Privat Vendor”, i licencuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), me objekt të veprimtarisë; aktivitetin radioteleviziv privat duke përfshirë prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablllove, përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**